

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Shkurt 2020

Tiranë, më 25 Mars 2020: Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Shkurt 2020, janë 616.496.


Krahasuar me Shkurt 2019, ky tregues rezulton me rritje 16,2 %. Në Shkurt 2020, hyrjet e shtetasve të huaj në vend janë 228.941. Krahasuar me Shkurt 2019, ky numër është rritur me 13,6 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë përgjatë dy muajve të 2020 është 478.402, duke u rritur me 16,4 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Në Shkurt 2020, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Polonia ka pasur rritjen më të madhe, ndërsa më të ulët e ka pasur SHBA, krahasuar me Shkurt 2019.

Përgjatë dy muajve të 2020, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Polonia ka pasur rritjen më të madhe me 40,4 % ndërsa uljen më të ndjeshme e ka pasur SHBA me 7,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Për publikim 25/03/2020

Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga vendi, gjatë muajit Shkurt 2020, janë 639.729 duke shënuar një rritje me 14,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Shkurt 2020, janë 393.598. Krahasuar me Shkurt 2019, ky numër është rritur 12,1 %. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Shkurt 2020, janë 246.131. Krahasuar me Shkurt 2019, ky numër është rritur 18,1 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë përgjatë dy muajve të 2020, është 924.663 duke u rritur 14,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Shkurt 2019	Shkurt 2020	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Shkurt 2019	Janar-Shkurt 2020	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Gjithsej	530.691	616.496	16,2	1.104.739	1.310.452	18,6
Shqiptarë	329.094	387.555	17,8	693.622	832.050	20,0
Të Huaj	201.597	228.941	13,6	411.117	478.402	16,4
Dalje Gjithsej	559.611	639.729	14,3	1.253.268	1.482.423	18,3
Shqiptarë	351.144	393.598	12,1	804.975	924.663	14,9
Të Huaj	208.467	246.131	18,1	448.293	557.760	24,4

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	Shkurt 2019	Shkurt 2020	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Shkurt 2019	Janar-Shkurt 2020	Ndryshimi vjetor (%)
Kosovë	58.489	70.648	20,8	124.538	148.280	19,1
Maqedonia e Veriut	29.419	34.230	16,4	59.434	72.264	21,6
Greqi	31.918	38.106	19,4	63.575	76.849	20,9
Itali	17.354	18.409	6,1	36.689	39.476	7,6
Angli	5.151	6.101	18,4	9.546	11.660	22,1
Mali i zi	21.185	27.337	29,0	45.610	58.227	27,7
Poloni	374	531	42,0	767	1.077	40,4
SHBA	3.131	3.218	2,8	6.786	7.277	7,2
Spanjë	362	497	37,3	755	964	27,7
Gjermani	2.338	3.024	29,3	5.244	6.298	20,1
Zvicër	907	1.234	36,1	2.552	2.860	12,1
Të tjera	30.969	25.606	-17,3	55.621	53.170	-4,4
Gjithsej	201.597	228.941	13,6	411.117	478.402	16,4

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Shkurt 2019	Shkurt 2020	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Shkurt 2019	Janar-Shkurt 2020	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Shtetas të Huaj	201.597	228.941	13,6	411.117	478.402	16,4
I. Personale	193.963	220.172	13,5	398.737	462.711	16,0
1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.	185.863	211.006	13,5	380.726	442.786	16,3
2. Trajtim shëndetësor	61	58	-4,9	66	95	43,9
3. Qëllime fetare	57	35	-38,6	156	73	-53,2
4. Udhëtarë transit	7.982	9.073	13,7	17.789	19.757	11,1
II. Biznes dhe profesionale	7.634	8.769	14,9	12.380	15.691	26,7

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Shkurt 2019	88.883	21.748	420.060	87.906	20.957	450.748
Shkurt 2020	98.100	23.301	495.095	96.449	21.063	522.217
Ndryshimi vjetor (%)	10,4	7,1	17,9	9,7	0,5	15,9
Janar-Shkurt 2019	191.229	44.288	869.222	207.139	68.495	977.634
Janar-Shkurt 2020	213.130	49.040	1.048.282	228.590	69.772	1.184.061
Ndryshimi vjetor (%)	11,5	10,7	20,6	10,4	1,9	21,1

Metodologji

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi "vizitor" nënkupton "një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse".

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm, etj.;
2. Trajtim shëndetësor;
3. Qëllime fetare;
4. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/> politika e revizionimit statistikor.

Diferencat statistikore midsis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.